

PROTOKOLLI I AUTOMATIZUAR I VLERËSIMIT TË SIGURISË – INSTRUMENTI I EKSPLOZIVËVE

1. Të përgjithshme

1.1. Protokollin e automatizuar të vlerësimit të sigurisë – Eksplozivët (Automated Safety Assessment Protocol – Explosives, ASAP-X) është një fletëllogaritëse e Microsoft Excel e projektuar për të ndihmuar personelin e komponentit të Departamentit të Mbrojtjes (DoD)/NATO-s për vlerësimin e rreziqeve që shoqërohen me pasojat e sigurisë për distancën/sasinë e eksplozivit (Explosive safety Quantity-Distance – ESQD). Kjo fletëllogaritëse është projektuar për t'u përdorur nga Microsoft Excel 2003 dhe nga versione të mëparshme të Microsoft Excel. Ajo përbëhet nga tre fletë të veçanta të punës, e para është faqja e emrit/kontrollit të versionit/datës/udhëzimeve, e dyta është faqja me informacionet e futura dhe e treta është faqja me rezultatet.

1.2. Përshkrimet për fletën e punës ASAP-X me informacionet e futura dhe rezultatet:

1.2.1. Fleta e dytë e punës ASAP-X përdoret vetëm për informacionet e futura. Fleta e punës ASAP-X për informacionet e futura përdoret për të vlerësuar të gjitha pasojat e sigurisë së eksplozivëve që lidhen me depot e mundshme të eksplozivëve (potential explosive site – PES) (me përjashtim të detonimit të qëllimshëm, hangarëve të fortifikuar për avionë, një PES-je të nëndheshme, dhe poligoneve profesionale për asgjësimin e lëndëve shpërthyes (explosive ordnance disposal – EOD)). Përdoruesi duhet të plotësojë qelizat e duhura të fletës së punës të ngjyrosura me ngjyrë të verdhë e që ndodhen në këtë faqe. Të gjitha qelizat e tjera janë të bllokuara dhe përdoruesi nuk mund të bëjë ndonjë ndryshim/modifikim të këtyre qelizave.

1.2.2. Fleta e tretë e punës ASAP-X ofron rezultate për të gjithë punën e bërë në ASAP-X. Përdoruesi nuk ka asnjë të dhënë dhe nuk mund të bëjë ndryshime/modifikime në këtë faqe.

1.3. Ky version i ASAP-X është bazuar mbi Botimin 1 për Magazinimin dhe transportimin e municioneve të aleatëve (Allied Ammunition Storage and Transport Publication 1 – AASTP-1), Manualin e parimeve të sigurisë së NATO-s për Magazinimin e municioneve ushtarake dhe eksplozivëve, Shtator 2009.

1.4. Nëse ekziston një devijim që lidhet me distancën ndërmjet depove (intermagazine distance – IMD), përdoruesve u kujtohen kategoritë e rrezikut (Hazard Division - HD) për PES-të, peshat neto të eksplozivëve (net explosives weights – NEQs) janë totali i të gjitha NEQ-ve në të gjitha vendndodhjet e PES-ve që përfshihen në devijim. Një devijim i lidhur me IMD-në ndërmjet dy vendndodhjeve të tilla, në fakt mund të bëjë që vendndodhje të tjera shtesë të kenë devijime që lidhen me IMD-në. Gjatë trajtimit të devijimeve të lidhura me IMD-në është e rëndësishme që të identifikohen saktësisht rreziqet e eksplozivëve dhe të vlerësohen të gjitha rreziqet shoqëruese.

1.5. ASAP-X nuk kërkon rregulla përzierje. Janë përfshirë NEQ të veçanta sipas HD-ve për t'u lejuar përdoruesve që të fusin HD të ndryshme si për shembull për të përcaktuar depot. Kjo lejon ASAP-X që të përlllogarisë distancën maksimale për çdo sasi individuale të HD-së dhe ta përdorë atë për të nxjerrë rezultate. Nëse PES-ja ka artikuj të përzierë, atëherë përdoruesi duhet të fusë sasinë totale në përputhje me AASTP-1 dhe ta fusë këtë sasi në kutinë e futjes së informacionit në NEQ-në e HD 1.1.

2. Udhëzimet e ASAP-X

2.1. Kur hapet fletëllogaritësja ASAP-X, shfaqet faqja e parë e emrit/kontrollit të versionit/datës/udhëzimeve. Kjo lejon përdoruesin që të lexojë këto udhëzime për përdorimin e ASAP-X. Ato gjenden në të djathtë të zonës së Version Control (Kontrollit të versionit).

2.2. Më pas përdoruesi duhet të klikojë në fillim në skedën Fleta e punës së faqes me informacionet e futura.

2.2.1. Në fillim duhet të futet emri i PES-së dhe një përshkrim i shkurtër i PES-së.

2.2.2. Më pas duhet të futen NEQ-të (në kilogram). Përdoruesi nuk duhet të harrojë se ASAP-X nuk aplikon rregulla përzierjeje. Nëse kjo PES ka artikuj të përzierë, atëherë përdoruesi duhet të fusë sasinë totale në përputhje me AASTP-1 dhe këtë numër ta fusë në kutinë e NEQ-së të HD 1.1.

2.2.3. Më pas duhet t'i jepet përgjigje pyetjes “Is the PES an open pad, earth-covered magazine (ECM), or Other?” (A është PES-ja një shesh i hapur, një depo e mbuluar me dhe (earth-covered magazine – ECM), ose diçka tjetër?), në të djathtë të HD NEQs-ve. Ajo ka një listë me lëshim poshtë që e shoqëron për ta kufizuar përgjigjen të tillë që të kuptohet nga ASAP-X. Kjo do të përcaktojë nëse duhet t'i jepet përgjigje ndonjë pyetjeje tjetër në ekran. Nëse shfaqet një pyetje tjetër, ajo do të ketë një listë me lëshim poshtë për t'i kufizuar përgjigjet sipas ASAP-X. Këto përgjigje do t'i japin informacione ASAP-X që të përcaktojë rezultatet e përlllogaritura në faqen e rezultateve.

2.2.4. Zona tjetër për të futur informacione është me të dhënat e depos së ekspozuar (Exposed Site – ES). Kjo përfshin emrin e ES-së, distancën që ES-ja ka nga PES-ja, numrin e personelit që ndodhet në ES, koston e ndërtesës së ES-së, dhe nëse PES-ja është një ECM, orientimi i ES-së kundrejt PES-së do të jetë kolona e fundit. Nëse PES-ja është një ECM, kolona e orientimit do të ketë një listë me lëshim poshtë për të kufizuar përgjigjet sipas ASAP-X. Distancat në ASAP-X duhet të futen në metra. ASAP-X ka vend për 85 ES të veçanta. Kutitë për futjen e informacionit do të shfaqen sipas nevojave të përdoruesit.

2.2.5. Nëse distanca ndërmjet ES-së dhe PES-së nuk dihet, ASAP-X përfshin një përlllogaritës të koordinatave të Sistemit Global të Pozicionimit (GPS) për të përcaktuar distancën ndërmjet ES-së dhe PES-së. Ky përlllogaritës i kërkon koordinatat e GPS-së në gradë, minuta, sekonda dhe drejtimin, si për gjatësinë, ashtu dhe për gjerësinë gjeografike. ASAP-X do ta përlllogarisë distancën e saktë në metra. Nëse futet një numër në kolonën “Dist from PES”

(Distanca nga PES), ASAP-X do ta përdorë këtë distancë për përllogaritje edhe nëse janë futur koordinatat e GPS-së.

2.3. Kur të gjitha informacionet futen në ASAP-X, përdoruesi më pas duhet të hapë fletën e punës për rezultatet. Në këtë fletë pune është paraqitur një figurë e ndarë në shtatë zona të ndryshme. Këto zona paraqesin nga më e brendshmeja deri tek më e jashtmeja, kriteret e shpërthimit të eksplozivëve. Secila nga këto zona do të jetë e shoqëruar me një distancë në varësi të HD-së dhe NEQ-së që është futur.

2.4. Në të djathtë të vizatimit të ndarë në zona në fletën e punës për rezultatet ndodhet një listë e secilës ES dhe të dhënat përkatëse të rezultateve për atë ES individuale për sa i përket distancës, zonës, personelit, viktimave të mundshme, kostos së ndërtesës dhe humbjeve nga dëmtimi i ndërtesës.

2.5. Poshtë vizatimit të ndarë në zona në fletën e punës për rezultatet ndodhet një listë e hartuar sipas zonave, si edhe për të gjithë zonën e vlerësimit.